



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 09.02.2026

MBLEDHJA Nr. 07,
Datë 11.02.2026, ora 11:00
e Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 11.02.2026, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 07, e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin janar 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “INFO-Telecom” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj “Raiffesisen Bank” sh.a.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “PARISOL” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI

Petrit AHMETI